



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije /
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve

Vlerësimi i brendshëm për
vazhdim/përtërirje të licencës së
karrierës

MASHTI, 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 016/041
Data: 29.04.2024

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. z. e Republikës së Kosovës/nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë), nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e Udhëzuesit për VPM

1. Miratohet Udhëzuesi për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve për ripërtëritjen e licencës së karrierës së mësimdhënësve.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, Kornizën Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënies në Kosovë, Udhëzimit administrativ nr.14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie, Udhëzimit administrativ nr. 15/2023 për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve si dhe nevojën e miratimit të Udhëzuesit për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve për ripërtëritjen e licencës së karrierës së mësimdhënësve, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. DAP/MASHTI;
2. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
3. KSHLM;
4. Arkivit /MASHTI.



I. HYRJE

Ky udhëzues është përgatitur nga MASHTI me qëllim që të informoj për politikën për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve (VPM), në mënyrë të veçantë vlerësimin e brendshëm për përtëritje të licencës së karrierës.

Qasja e ndjekur në përgatitjen e këtij udhëzuesi, ka referencë hierarkinë e politikave arsimore që rregullojnë dhe lidhen me zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë. Kjo qasje ka referencë tri politikave arsimore më poshtë:

1. Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënies në Kosovë¹
2. Udhëzimi administrativ 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie²
3. Udhëzimi administrativ 15/2023 për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve³

Procesi i vlerësimit u ndihmon mësimdhënësve të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies. Prandaj, sugjerojmë që së pari referojuni Kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënies në Kosovë, e cila përcakton standardet e mësimdhënies, të cilat do të jenë referenca kryesore për përgatitjen e mësimdhënësve, mbështetjen për zhvillimin e tyre profesional, vlerësimin e performancës dhe promovimin e karrierës për mësimdhënës. Pastaj, bazohuni në UA 15/23 sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie, si dhe në fund i referoheni UA nr. 15/2023 për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.

Sipas Kornizës, për secilin standard, segmenti i fushave ofron një ilustrim më të detajuar të vlerave të synuara të mësimdhënies, njohurive, praktikave, të nxënies dhe angazhimit. Këto fusha përshkruajnë dhe identifikojnë komponentët e të nxënies cilësore për secilën fazë të karrierës së mësimdhënësve në Kosovë. Një mësimdhënës efektiv është në gjendje të integrojë dhe zbatojë njohuritë, praktikën dhe angazhimin profesional, në mënyrë që të krijojë një mjedis të të nxënies në të cilin të nxënies vlerësohen në mënyrë të efektshme. Meqenëse të gjithë mësimdhënësit në detyrë në Kosovë kanë licencën e karrierës, instrumentet e përgatitura për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve përdoren për qëllim të vazhdimit/përtëritjes së licencës së karrierës.

Sipas standardeve dhe kompetencave të përcaktuara, në këtë fazë (mësimdhënës i karrierës) mësimdhënësi pajiset me licencën e karrierës, e cila lëshohet për shtatë vite. Licenca e mësimdhënësit të karrierës duhet të përtërihet çdo shtatë vjet, me kusht që mësimdhënësi të ketë kryer 100 orë trajnim gjatë gjithë kohëzgjatjes së licencës dhe të ketë demonstruar kërkesat minimale të performancës për ripërtëritjen e licencës së karrierës.

Në fazën e licencës së karrierës, aftësitë e kërkuara përqendrohen në zotërimin e lëndës, zgjerimin e repertoarit të aftësive pedagogjike, metodologjitë dhe teknikat e mësimdhënies, vlerësimin e nxënësve dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimit për përshtatjen e mësimdhënies me kërkesat dhe kapacitetet e nxëniesit.

Ky udhëzues është i ndarë në tri pjesë.

- ⇒ Në të parën do të gjeni prezentimin e standardeve të mësimdhënies, treguesit e performancës dhe profilin e kompetencave për mësimdhënësit, të përcaktuara me Kornizën strategjike.
- ⇒ Në pjesën e dytë do të gjeni një përshkrim të sistemit dhe bartësit e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës.
- ⇒ Në pjesën e tretë janë përshkruar formularët për realizim të VPM të brendshëm, janë ofruar udhëzime për përdorim, si dhe janë paraqitur katër formularët për realizim të VPM.

Procesi i VPM të brendshëm, bazohet në kapacitetet e shkollës me besimin dhe bindjen se shkollat tashmë kanë udhëheqje të përgjegjshme dhe profesionale për administrim të këtij procesi, si dhe mësimdhënësit kanë kapacitetet e nevojshme për realizimin e tij.

¹ <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/kornize-strategjike.pdf>

² UA 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/06/Udhëzimi-administrativ-me-nr-14-rotated-1.pdf>

³ UA 15/2023 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/06/Udhëzimi-administrativ-me-nr-15-rotated-1.pdf>

I. FUSHAT, STANDARDET, TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE PROFILI I KOMPETENCAVE PËR MËSIMDHËNËS KARRIERE

Sipas standardeve dhe kompetencave të përcaktuara në Kornizën Strategjike, mësimdhënësi pajiset me licencën e karrierës, e cila lëshohet për shtatë vite. Licenca e karrierës duhet të përtërihet çdo shtatë vite, me kusht që mësimdhënësi të ketë kryer së paku 100 orë trajnim gjatë kohëzgjatjes së licencës dhe të ketë demonstruar kërkesat e performancës sipas profilit përkatës të kompetencave.

Në fazën e licencës së karrierës, aftësitë e kërkuara përqendrohen në zotërimin e lëndës, zgjerimin e repertoarit të aftësive pedagogjike, metodologjitë dhe teknikat e mësimdhënies, vlerësimin e nxënësve dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimit për përshtatjen e mësimdhënies me nxënësit, motivimin e tyre, punën ekipore me kolegët, grupet profesionale të bazuara në lëndë, prindërit dhe komuniteti.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur: Fushat e mësimdhënies, standardet, treguesit e performancës, profili i kompetencave.

Fushat	Standardet	Treguesit e performancës	Profili i kompetencave për mësimdhënësit e karrierës
Vlerat profesionale, qëndri met dhe sjelljet	1.Njeh dhe i mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHTI/përgj egjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës.	1.1.Bazohet në praktikën e mësimdhënies në vlerat dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe në kodin e mirësjelljes të MASHTI	I respekton parimet kryesore të përshkruara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës dhe kodin e mirësjelljes së MASHTI të themeluar nga autoritete rregulluese, sisteme dhe shkolla dhe i kupton implikimet e politikave dhe proceseve relevante ligjore, administrative dhe organizative: <ul style="list-style-type: none"> ● Respekton orarin e punës ● Kujdeset dhe ruan pronën e shkollës, si dhe e mirëmban një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm mësimor ● Respekton detyrat dhe obligimet e punës ● Ruan besimin dhe konfidencialitetin profesional
		1.2.I kryen detyrat dhe obligimet e mësimdhënies me profesionalizëm, përkushtim të lartë, ndershmëri dhe saktësi	
		1.3.E njeh dhe i respekton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të profesionit, duke e përfshirë orarin mësimor, menaxhimin e kohës	
Njohuri të profesionale	2.Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive	2.1.E kupton zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve dhe e promovon mësimin gjatë gjithë jetës.	<ul style="list-style-type: none"> ● Përdor strategji të mësimdhënies dhe të vlerësimit në bazë të njohjes së karakteristikave fizike, shoqërore dhe intelektuale të të gjithë nxënësve, duke i përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta

dhe të kuptuarit	për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit.	2.2. I njeh nxënësit se si mësojnë, si dhe i përkrah në arritjen e rezultateve mësimore	I strukturon programet e mësimdhënies duke i shfrytëzuar hulumtimet dhe këshillat kolegjiale për mënyrën aktive të mësimit të nxënësve duke: <ul style="list-style-type: none"> ● Përdorur teknika të ndryshme për pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin e mësimdhënies, si dhe i inkurajon nxënësit që të arrijnë potencialin e tyre të mundshëm ● Krijuar një mjedis, i cili <i>e maksimizon</i> mësimin dhe shfrytëzon strategji të <i>ndryshme</i> të mësimdhënies që u përshtatet nevojave individuale të nxënësve
		2.3. I trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt	<ul style="list-style-type: none"> ● Planifikon dhe zbaton strategji të mësimdhënies që janë të përgjegjshme sa i përket përparësive dhe nevojave të nxënësve nga grupet e ndryshme gjuhësore, kulturore, fetare dhe shoqërore-ekonomike
		2.4. Krijon mjedis të sigurt dhe mbështetës mësimor, që e maksimizon nxënien dhe i inkurajon nxënësit që të bëhen persona që i zgjidhin problemet, që janë vendimmarrës, që mësojnë gjatë tërë jetës, si dhe që bëhen pjesëtarë të dobishëm të shoqërisë	<ul style="list-style-type: none"> ● Planifikon dhe zbaton teknika efektive për inkurajimin e mendimit të nivelit të lartë dhe të mësimit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë mundësi për nxënës që t'i praktikojnë njohuritë e tyre në mënyrë të pavarur
		3. Demonstron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës.	3.1. E njeh përmbajtjen e fushës mësimore në kurrikulën e Kosovës
	3.2. Di si të jep mësim për përmbajtjen mësimore, duke shfrytëzuar teknika të ndryshme efektive	<ul style="list-style-type: none"> ● Organizon përmbajtje në kuadër të një mësimnxënie koherente dhe të organizuar mirëfilli, si dhe i shfrytëzon teknikat e ndryshme efektive të mësimdhënies 	
	3.3. Bën mësimdhënie të diferencuar për ta mbështetur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, si dhe për t'i trajtuar nevojat e veçanta mësimore të nxënësve me aftësi të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> ● Zhvillon aktivitete të mësimdhënies që përfshijnë strategji të diferencuara për t'i angazhuar të gjithë nxënësit si dhe për t'i përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të ndryshme 	

		3.4. Zotëron strategji të ndryshme për menaxhimin e klasës	<ul style="list-style-type: none"> ● Themelon dhe e ruan një rutinë që ka rregull dhe është funksionale për krijimin e një mjedisi ku koha e nxënësit kalohet duke kryer detyra mësimore ● Sjelljet sfiduese trajtohen duke përcaktuar pritje të qarta të nxënësit, si dhe duke i trajtuar çështjet disiplinore me kujdes, drejt dhe me respekt të plotë.
Shkathtësitë dhe praktik a profesionale	4. Planifikon zbatim efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies.	4.1. Përcakton qëllime sfiduese të mësimin	<ul style="list-style-type: none"> ● Përcakton qëllime të qarta, sfiduese dhe të arritshme të mësimin për të gjithë nxënësit
		4.2. Përdor strategji të llojllojshme të mësimdhënies për t'i motivuar nxënësit dhe nxisë të menduarit e nivelit të lartë	<ul style="list-style-type: none"> ● Aplikon njohuritë e përmbajtjes dhe strategjive të mësimdhënies së një fushe mësimore për të zhvilluar aktivitete të suksesshme të mësimdhënies
		4.3. I përzgjedh dhe i shfrytëzon burimet e duhura; Krijon materiale mësimore për temat e caktuara ku mungon literatura	<ul style="list-style-type: none"> ● Përzgjedh dhe/ose krijon dhe shfrytëzon lloje të ndryshme të burimeve, duke përfshirë TIK-un, për t'i angazhuar nxënësit në mësim
		4.4. Përdor teknologji adekuate në mënyrë adekuate – sigurt, me përgjegjësi dhe me etikë	<ul style="list-style-type: none"> ● Inkorporon strategji për promovimin e shfrytëzimit të sigurt, të përgjegjshëm dhe etik të TIK-ut në procesin e mësimnxënies dhe mësimdhënies
	5. Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyese dhe raporton sa i përket mësimin të nxënësve.	5.1. E vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësve si dhe komunikon shpesh me nxënësit për t'iu ofruar informata kthyese në mënyrë konstruktive	<ul style="list-style-type: none"> ● Harton, përzgjedh dhe shfrytëzon strategji joformale, formale, diagnostike, formative dhe përmbledhëse për vlerësimin e mësimin të nxënësve/për verifikimin e nivelit të arritjes së nxënësve sa i përket njohurive, sjelljeve dhe shkathtësive.
		5.2. Planifikon plotësimin e zbrazëtive të të arriturat e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> ● Bën plan të thjeshtë për plotësimin e zbrazëtirave tek të arriturat e nxënësve.
		5.3. I interpreton të dhënat nga vlerësimi i nxënësve për të përmirësuar nxënien e tyre	<ul style="list-style-type: none"> ● Shfrytëzimi i të dhënave të vlerësimin të nxënësve për analizimin dhe vlerësimin e të kuptuarit të nxënësve për lëndën/përmbajtjen, identifikimi i intervenimeve dhe modifikimi i mësimdhënies

		5.4. Raporton arritjet e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> Raporton çartë, saktë dhe me plot respekt të nxënësit dhe prindërit/kujdestarët për suksesin e nxënësve, duke i shfrytëzuar të dhënat e sakta dhe të besueshme. Po ashtu u jep nxënësve informata kthyesë konstruktive dhe aktuale për mësimin e tyre gjatë orës mësimore
Mësimi dhe angazhimi profesional	6. Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional.	6.1. I identifikon dhe i planifikon nevojat profesionale për mësim	<ul style="list-style-type: none"> I shfrytëzon standardet profesionale të mësimdhënësit dhe për burime të ndryshme në dispozicion të të dhënave për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional
		6.2. Përdor mësim të ri profesional për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> Merr pjesë në sesione të duhura trajnuese dhe mundësi për të mësuar për t'i freskuar dhe përmirësuar njohuritë dhe praktikën e mësimdhënies që kanë të bëjnë me nevojat profesionale dhe me prioritetet e shkollës dhe/ose sistemit
		6.3. Angazhohet me kolegë për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> Merr pjesë në diskutimet kolegjiale dhe i aplikon informatat konstruktive të dhëna nga kolegët për përmirësimin e njohurive profesionale dhe praktikës së mësimdhënies. Këtu përfshihet zgjidhja e problemeve që kanë të bëjnë me nxënësit, klasën dhe shkollën
		6.4. I përshtat dhe i përmirëson praktikatat e mësimdhënies përmes nxënies dhe reflektimit	<ul style="list-style-type: none"> Demonstron praktikë reflektuese, duke përfshirë informata kthyesë nga të dhënat e nxënësve dhe këshilla nga drejtori i shkollës, inspektori, kolegët, dhe nga hulumtimet aktuale për të përmirësuar praktikën mësimore
	7. Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.	7.1. Angazhohet për të krijuar mjedis bashkëpunues me kolegë	<ul style="list-style-type: none"> Punon bashkë me kolegë për hartimin e planeve të mësimdhënies, për shkëmbimin e mjeteve mësimore, dhe për reflektimin në kuadër të aktivave profesionale
		7.2. Komunikon në mënyrë efektive me nxënës, prindër/ kujdestarë dhe kolegë	<ul style="list-style-type: none"> Themelon dhe ruan marrëdhënie të respektueshme bashkëpunimi me prindër/kujdestarë sa i përket

			mësimi të mirëfilltë dhe mirëqenies së nxënësve dhe i ndihmon që të bëhen pjesëmarrës aktiv në arsimimin e fëmijëve
		7.3. Angazhohet me rrjete të ndryshme profesionale të bashkëpunimit në fushën e mësimdhënies si dhe në bashkësi më të gjera profesionale dhe i promovon njohuritë si dhe debaton për problemet relevante të fushës së arsimit	<ul style="list-style-type: none"> ● Merr pjesë në rrjete profesionale, të bashkësisë dhe në forume për t'i zgjeruar njohuritë, për ta përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe për të shërbyer profesionalisht, p.sh. në organe dhe komisione të ndryshme të shkollave
		7.4. Ndërmerr hulumtime në veprim në mjedisin shkollor ku vepron	<ul style="list-style-type: none"> ● Identifikon problematika të ndryshme në klasë të cilat mund të jenë fokus i hulumtimeve në veprim

II. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNËSVE (VPM) – SISTEMI DHE BARTËSIT E PROCESIT

Sistemi i vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve përbëhet nga vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm. Njohja e këtij sistemi të VPM dhe përgjegjësi të bartësve të këtij sistemi, në radhë të parë siguron respektim të legjislacionit në fuqi, e pastaj siguron transparencë për procesin e vlerësimit, si dhe zbatim të një qasje standarde dhe të bazuar në kriteret dhe procedurë të qarta. Në vijim prezentohen informatat bazë nga UA për VPM 15/2023.

Vlerësimi i brendshëm i referohet procesit të:

- Vetëvlerësimit,
- Vlerësimit nga mësimitdhënësit,
- Vlerësimit nga drejtori i shkollës, dhe
- Vlerësimi nga nxënësit.

Instrumentet për vlerësim të brendshëm janë:

- Formulari për vetëvlerësim nga mësimitdhënësi,
- Formulari për vlerësim nga mësimitdhënësit/kolegët,
- Formulari për vlerësim nga drejtori i shkollës,
- Formulari për vlerësim nga nxënësit.

Vlerësimi i jashtëm i referohet procesit të vlerësimit të mësimitdhënësit nga Ministria dhe Inspektorati i Arsimit. Vlerësimi i jashtëm nga Ministria realizohet për licencë të avancuar dhe përfshin vlerësimin me shkrim të mësimitdhënësit i cili aplikon për licencë të avancuar në mësimitdhënie. Ndërsa vlerësimi i jashtëm nga Inspektorati i arsimit bëhet me përfshirje të ekspertëve të fushave të kurikulës dhe realizohet në rastin kur mësimitdhënësit aplikon për licencë të avancuar në mësimitdhënie.

Bartësit e procesit të vlerësimit të performancës janë:

- Ministria;
- Inspektorati i Arsimit;
- Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA);
- Drejtori i shkollës;
- Mësimitdhënësi.

III. PËRGJEGJËSITË E BARTËSVE NË RAPORT ME VPM TË BRENDSHËM, SIPAS UA 15/2023

MASHTI është përgjegjëse të:

- Mbikëqyrë cilësinë e funksionimit të sistemit të vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve;
- Shqyrtojë raportet përmbledhëse të Inspektoratit të Arsimit për vlerësim të performancës së mësimitdhënësve;
- Në koordinim me Inspektoratin e Arsimit dhe DKA-të ndërmerr masa për përmirësim të gjendjes në fushën e mësimitdhënies.

Inspektorati i Arsimit (IA):

- Siguron që vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve bëhet në përputhje me ligjin;
- Mbledh të dhëna nga të gjithë komponentët e sistemit të vlerësimit të performancës;
- Mbikëqyrë procesin e realizimit të VPM të brendshëm të realizuar nga shkolla dhe DKA;
- Bën rekomandimet e nevojshme për zhvillim profesional të vazhdueshëm të mësimitdhënësve në përputhje me sistemin e vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve;
- Rekomandon për revokim të licencës, përtëritje apo avancim të mësimitdhënësve;
- Përgatit raport vjetor për procesin e vlerësimit të performancës të realizuar nga DKA dhe shkolla.

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA):

- Mbështet drejtorët e shkollave për përgatitjen e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimitdhënësve;
- Themelon ekipet komunale për planifikim dhe mbështetje të shkollave në realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimitdhënësve;
- Në bashkëpunim me ekipin komunal, analizon rezultatet e vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve në nivel shkolle dhe komune;
- Harton planin komunal të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve bazuar në rekomandimet nga raportet për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së mësimitdhënësve.

Drejtori/ështet i/e shkollës:

- Planifikon procesin e vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimitdhënësve;
- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme punën e mësimitdhënësve;
- Formon ekipin me bazë në shkollë për realizim të komponenteve të vlerësimit të brendshëm të performancës duke përfshirë drejtorin/ zëvendësdrejtorin, koordinatoren e cilësisë, kryetarin e aktivitetit profesional, mësimitdhënës të fushës/lëndës, psikolog/pedagog;
- Shqyrton dosjet personale profesionale të mësimitdhënësve të cilët i nënshtrohen procesit të VPM të brendshëm;
- Sigurohet që mësimitdhënësi ka ofruar dëshmi për përfundimin e së paku 100 orë të ZHPM nga data e marrjes së licencës aktuale;
- Shqyrton raportet vjetore të vlerësimit/monitorimit të mësimitdhënësve të kryera nga drejtori gjatë periudhave të ndryshme të vitit shkollor;
- Analizon formularin e vetëvlerësimit të mësimitdhënësve;
- Plotëson formularin e vlerësimit të mësimitdhënësve nga drejtori i shkollës;
- Evidenton dëshmitë e përdorura për nivelin e arritjes së standardeve të performancës duke i shënuar në formular dhe ruajtur në dosjen personale profesionale të mësimitdhënësve;
- Përkrahë mësimitdhënësin dhe ofron rekomandime në hartimin e planit për përmirësim sipas rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i performancës së mësimitdhënësve;
- Në bashkëpunim me ekipin me bazë në shkollë, përgatitë raport vjetor për DKA për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimitdhënësve.

Mësimdhënësi/ja:

- Respekton të gjitha procedurat ligjore në fuqi për vlerësim të performancës së mësimdhënësve;
- Përgatitë dosjen personale profesionale për të dëshmuar përfundimin e orëve të ZHPM (të paktën 100), si dhe ofron dëshmi për punën dhe arritjet personale profesionale nga data e marrjes së licencës aktuale të karrierës;
- Bën vetëvlerësimin e performancës sipas formularit dhe udhëzimeve përkatëse;
- Në bashkëpunim me drejtorin e shkollës përpilon planin e përmirësimit dhe zhvillimit profesional.

IV. FORMULARËT PËR VPM TË BRENDSHËM – UDHËZIME PËR PËRDORIM TË FORMULARËVE/INSTRUMENTEVE

Ky udhëzues përmban 4 formularë (F). Secili formularë ka numër të caktuar të pikëve (%) si më poshtë:

- F1. Vlerësimi nga drejtori (40 %)
- F2. Vetëvlerësimi nga mësimdhënësi (25 %)
- F3. Vlerësimi nga kolegët (25 %)
- F4. Vlerësimi nga nxënësit (10 %).

⇒ **Kalueshmëria** – kushti për përtëritje të licencës së karrierës është arritja e minimumit prej 80 % të pikëve kumulative përmes katër formularëve/instrumenteve të vlerësimit.

⇒ Në rast se mësimdhënësi nuk e arrin minimumin e pikëve dhe nuk i plotëson kërkesat minimale për përtëritje të licencës, rekomandohet që brenda një viti të ndjekë programe shtesë të trajnimit.

⇒ Pas përfundimit të programeve shtesë të trajnimit, mësimdhënësi i nënshtrohet rivlerësimit të performancës.

⇒ Nëse edhe në këtë rast nuk plotësohen kërkesat minimale të performancës, atëherë mësimdhënësit i merret licenca e mësimdhënies.

V. SI DUHET TË PLOTËSOHEN FORMULARËT PËR REALIZIM TË VPM TË BRENDSHËM?

Plotësimi i formularëve për realizim të VPM të brendshëm është një proces i bazuar në dëshmi apo evidenca për punën e mësimdhënësve, në kërkesat e formularëve për vlerësim të drejtë, objektiv dhe të argumentuar me qëllim që vlerësimi të jetë efektiv dhe i krahasueshëm.

I gjithë procesi i plotësimit të formularëve për VPM udhëhiqet në bazë të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara për bartësit e vlerësimit të brendshëm, proces i cili dhe dokumentohet me formularët përkatës të vlerësimit.

1. Formulari për vlerësim nga drejtori (F1)

Drejtori është përgjegjës të udhëheqë dhe të administrojë tërë procesin e VPM të brendshme për secilin mësimdhënësi të shkollës. Drejtori sigurohet që mësimdhënësi i plotëson kriteret për t'ju nënshtroar procesit të vlerësimit, si dhe përgatitë planin për VPM së bashku me ekipin për realizim të VPM-së në shkollë.

Drejtori është përgjegjës të:

- Përgatisë planin për vëzhgim në bashkëpunim me ekipin e shkollës;

- Shqyrton dosjen personale profesionale të mësimdhënësve;
- Plotëson formularin për vlerësim nga drejtori (F1);
- Shqyrton raportet e vetëvlerësimit (F2) dhe përgatitë raportin përmbledhës duke përfshirë pikët e akumuluar dhe fushat për përmirësim në formularin F5;
- Shqyrton raportet e vëzhgimit (F3) nga kolegët dhe përgatitë raportin përmbledhës duke përfshirë pikët e akumuluar dhe fushat për përmirësim në formularin F5;
- Analizon vlerësimet nga nxënësit (F4) dhe përgatitë raportin përmbledhës duke përfshirë pikët e akumuluar dhe fushat për përmirësim në formularin F5;
- Përgatitë raportin përmbledhës (formulari F5), plani personal për ZHP të mësimdhënësit, bazuar në gjetjet nga vlerësimi i brendshëm. Gjithashtu, propozon një plan orientues për zhvillim profesional deri në afatin e përtërirjes së licencës së karrierës;
- Dorëzon raportin përmbledhës në DKA dhe MASHTI.

2. Vetëvlerësimi nga mësimdhënësi (F2)

Secili mësimdhënës, gjatë procesit të VPM të brendshëm, plotëson formularin për vetëvlerësim (F2). Mësimdhënësi është përgjegjës të ofroj sqarime për vetëvlerësimin e bërë duke përmendur burimet dhe dëshmitë e përdorura.

Gjithashtu, mësimdhënësi identifikon 4 fusha për zhvillimin profesional deri në ciklin e radhës të VPM të brendshëm.

3. Vlerësimi nga kolegët (F3)

Secili aktiv profesional propozon një deri tre mësimdhënës të cilët/at janë anëtarë të ekipit përgjegjës për vëzhgim të kolegëve. Ekipi i mësimdhënësve vëzhgues emërohet nga drejtori i shkollës dhe ndryshohet çdo vit shkollor në muajin shtator të vitit përkatës. Vëzhgimi realizohet gjatë një jave të mësimin, me së paku dy e më së shumti 4 orë mësimore të vëzhguara.

Mësimdhënësi vëzhgues është përgjegjës të:

- Përgatis planin për vëzhgim në bashkëpunim me mësimdhënësin që do të vëzhgohet;
- Plotëson formularin F3. Numri i formularëve varet nga numri i orëve të vëzhguara;
- Ndan dhe diskuton raportin me mësimdhënësin e vëzhguar;
- Nënshkruan raportin së bashku me mësimdhënësin e vëzhguar;
- Dorëzon te drejtori formularët e plotësuar dhe raportin e nënshkruar;
- Administron vlerësimet nga nxënësit dhe i dorëzon te drejtori.

4. Vlerësimi nga nxënësit (F4)

Vlerësimi nga nxënësit bëhet duke përzgjedhur një/dy paralele me të cilat punon mësimdhënësi. Në vlerësim përfshihen të gjithë nxënësit e paraleles. Formulari prezantohet, administrohet dhe analizohet nga një anëtar i ekipit me bazë në shkollë për realizim të komponenteve të vlerësimit të brendshëm të performancës.

Anëtari i ekipit - mësimdhënësi i caktuar nga drejtori i shkollës, është përgjegjës të:

- Përgatis planin për administrim të vlerësimit nga nxënësit;
- Shpërndan formularin F4. Numri i formularëve varet nga numri i nxënësve të paraleles;
- Në klasën parafillore dhe klasat 1 deri 5 formularin e administron anëtari i ekipit të shkollës. Administrimi bëhet në formën e bashkëbisedimit me nxënësit e klasës duke mbajtur shënim për përgjigjet autentike të nxënësve të klasës së mësimdhënësit në proces të VPM të brendshëm;
- Në klasat 6 deri 12 formulari administrohet nga një anëtar i ekipit të shkollës dhe plotësohet në mënyrë anonime nga të gjithë nxënësit e klasës. Numri i paraleleve të përfshira si mostër për vlerësim është së

- paku një e jo më shumë se dy paralele me të cilat punon mësimit në proces të VPM të brendshëm;
- Prezenton dhe sqaron qëllimin e vlerësimit të mësimit/es;
- Administron vlerësimet nga nxënësit dhe i dorëzon te drejtori;
- Analizon të dhënat e marra nga vlerësimi;
- Nënshkruan raportin me të dhënat e marra nga vlerësimi.
- Dorëzon te drejtori formularin e plotësuar dhe të nënshkruar.

VI. DISA ORIENTIME LIDHUR ME PLANIN E REALIZIMIT TË VPM TË BRENDSHËM, FORMIMIT DHE FUNKSIONIMIT E EKIPIT TË SHKOLLËS PËR VPM

Plani i realizimit të VPM të brendshëm

Shkollat përgatisin planin vjetor për realizim të VPM të brendshëm, i cili përmban:

- Të dhënat për ekipin e brendshëm për VPM;
- Listën e mësimit/esve, vitin kur i është lëshuar licenca e karrierës, numrin e licencës;
- Listën e mësimit/esve të cilët i nënshtrohen procesit të VPM gjatë një viti shkollor;
- Aktivitetet dhe dinamikën e muajve të vitit shkollor të planifikuar për realizim të VPM (sugjerohet: nga mesi i muajit tetor deri në mes të muajit dhjetor; mesi i muajit shkurt deri në fund të muajit prill/maj);
- Aktivitetet mund të jenë: informimi i mësimit/esve me instrumentet, procesin dhe dinamikën e VPM, konsultimet dhe këshillimet e ekipit të shkollës për VPM, realizimi i VPM, përgatitja e raporteve për VPM, si dhe aktivitete të tjera që shkolla apo ekipi i saj i VPM vlerëson se nevojiten për këtë proces – për të siguruar vlerësim të drejtë, objektiv dhe transparent;
- Planin javor për realizim të katër aspekteve të VPM.

Formimi dhe funksionimi i ekipit të shkollës për VPM

- Drejtori i shkollës e formon dhe e udhëheq ekipin e shkollës sipas udhëzimeve për përbërjen e tij.
- Vendimin për formim të ekipit e ndan me DKA-në.
- Në ekip mund të marrin pjesë: drejtori/ zëvendësdrejtori, koordinatori i cilësisë, kryetarë të aktivitetit profesional, mësimit/es të fushës/lëndës, psikologë/pedagogë.
